



MARRËVESHJE E BASHKËPUNIMIT

Mes

Universiteti "Haxhi Zeka"

Adresa: rr. Uçk, p.n. 30000, Pejë Kosovë
përfaqësuar nga Rektori, Prof.dr Armand Krasniqi

dhe

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Adresa : Blv. Gjergj Fishta, Nr.52, Tiranë
Përfaqësuar nga Rektori, Prof.Dr.Adrian Civici

Me dëshirën për të promovuar bashkëpunimin akademik, arsimor dhe kulturor mes institucioneve, palët kanë nënshkruar këtë marrëveshje bashkëpunimi, duke përcaktuar kushtet dhe afatet për realizimin e saj. Kjo marrëveshje do të zhvillohet brenda kuadrit të bashkëpunimit institucional dhe do të mundësojë avancimin e mëtejshëm të marrëdhënieve, duke shqyrtuar gjithashtu mundësitë e veçanta të bashkëpunimit që ofrojnë përfitime të ndërsjella për palët e përfshira."

Neni 1

Qëllimi I bashkëpunimit

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi është të mundësojë zhvillimin e bashkëpunimit akademik ndërmjet palëve nënshkruese, duke krijuar një partneritet të qëndrueshëm dhe të frytshëm në fushat profesionale, arsimore dhe shkencore. Ky bashkëpunim ka për qëllim të përfshijë të gjitha programet e studimit që organizohen dhe ofrohen nga palët përkatëse, duke siguruar mundësi të reja për studentët, profesorët dhe ekspertët në fushat përkatëse. Përmes këtij partneriteti, synohet forcimi i lidhjeve ndër universitare, rritja e mundësive për shkëmbimin e dijes dhe përvojave, si dhe promovimi i projekteve të përbashkëta kërkimore dhe zhvillimore që mund të kontribuojnë në avancimin e arsimit dhe shkencës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.



Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

Bashkëpunimi mes palëve do të zbatohet përmes, por jo i kufizuar në veprimtaritë e mëposhtme:

- Rrjetëzim dhe shkëmbim reciprok të mësimdhënësve;
- personelit të kërkimit, studentët dhe stafi tjetër për ligjerata, vizita dhe shkëmbimin e përvojave;
- Pjesëmarrjen e përbashkët dhe aplikimin për fonde të caktuara për arsimin, kërkimin dhe aktivitetet artistike;
- Aktivitete të përbashkëta arsimore, trajnuese dhe kërkimore;
- Organizimin e përbashkët të konferencave, simpoziumeve, kongreseve, seminarëve, kurseve, shkollave verore dhe dimërore ndërkombëtare dhe formave të tjera të bashkëpunimit me interes të përbashkët;
- Shkëmbimin e literaturës profesionale, teksteve mësimore dhe publikimeve të tjera universitare;
- Shkëmbimin e informacioneve në fushat me interes për të gjitha palët;
- Organizimi i programave të përbashkëta të studimit;
- Programme të veçanta akademike afatshkurta;
- Dhe, aktivitete të tjera me interes të përbashkët.

Neni 3

Zbatimi i aktiviteteve

Kushtet dhe mënyra e bashkëpunimit për secilin prej aktiviteteve të lartëpërmendura që do të implementohen në kuadër të kësaj marrëveshje të bashkëpunimit do të diskutohet dhe vendoset me shkrim përpara fillimit të aktiviteteve.

Bashkëpunimet e mbështetura në këtë marrëveshje do të përcaktohen në detaje në protokolle të veçanta të cilat do të nënshkruhen pasi njësitë Brenda universiteteve të kenë përcaktuar detajet e marrëveshjes në praktikë dhe më pas do të nënshkruhen nga përfaqësuesit e autorizuar të secilës palë.

Neni 4

Zbatimi i marrëveshjes

Palët bien dakord që të gjitha marrëveshjet financiare të nevojshme për zbatimin e kësaj marrëveshje duhet të ngociohen dhe do të varen nga disponueshmëria e fondeve. Asnjëra palë nuk do të ketë detyrim financiar ndaj palëve tjera në bazë të kësaj marrëveshje.



Neni 5

Vlefshmëria e marrëveshjes

Kjo marrëveshje do të hyj në fuqi në datën e nënshkrimit nga përfaqësuesit e secilës palë. Marrëveshja do të jetë në fuqi për periudhën pesë (5) vjeqare nga data e nënshkrimit nga palët.

Neni 6

Amandamentimet e marrëveshjes

Marrëveshja e bashkëpunimit mund të shtyhet në afat apo amendohet në pjesë të veqanta të saj, nese palët bien dakord.

Neni 7

Përfundimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje mund të përfundojë edhe përpara afatit të caktuar me iniciativën e ndonjëres palë, duke njoftuar me shkrim 12(dymbëdhjetë) muaj më parë.

Neni 8

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hartohet në dy kopje origjinale. Secila palë do të mbajë nga një (1) kopje.

Universiteti "Haxhi Zeka"

Prof.dr. Armand Krasniqi

Rektor

Datë: ____/____/____



REKTYORATI	
Nr./Br./No. <u>3065</u>	Nr./faq./Br. rtr./No. pg. <u>3</u>
Data / Datum / Date: <u>08.12.2025</u> / <u>Pejë / Poë</u>	

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Prof.Dr. Adrian CIVICI

Rektor

Datë: ____/____/____

